

VENDIM
Nr. 838, datë 3.12.2014

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 904, DATË 12.12.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVEDHE DOKUMENTACIONIT TË PËRFITIMIT TË NDIHMËS
EKONOMIKE NË ZONAT PILOT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pika 4, 20, 42 e 42/1, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 904, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Pas shkronjës “f”, të pikës 3, shtohen shkronjat “g”, “gj” dhe “h”, me këtë përmbajtje:
“g) Vërtetimin për regjistrimin në shkollë për fëmijët që fillojnë klasën e parë;
- gj) Vërtetimin për ndjekjen e shkollës lëshuar nga shkolla, i cili është i detyrueshëm për t’u dorëzuar dy herë brenda një viti shkollor;
- h) Fotokopje të librezës së vaksinimit që provon vaksinimin sipas kalendarit të detyrueshëm për grup-moshat e fëmijëve.”.

b) Pas pikës 17 shtohen pikat 17/1 dhe 17/2, me këtë përmbajtje:
“17/1. Për ata anëtarë të familjes, fëmijë, të cilët vërtetojnë se ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën 300 (treqind) lekë në muaj gjatë vitit shkollor.

17/2. Për ata anëtarë të familjes, fëmijë, të cilët vërtetojnë se janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një shtesë në masën 100 (njëqind) lekë për çdo vaksinë të kryer.”.

c) Në shtojcën 1, bashkëlidhur vendimit, formulari “Pjesa 1: Demografia e familjes” zëvendësohet me formularin me të njëjtin titull që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi fillojnë nga 1 dhjetori 2014 dhe përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Pjesa 1: Demografia e familjes

1

Te dhena personale

Mbiemri

Emri

2

Numri i identifikimit kombëtar të aplikantit ashtu siç tregohet në kartën e identitetit

3

Adresa

Kodi-postar

Bashki/komune

Qarku

Ju do të merren informacione me postë, por në disa raste, do të dëshironim të lidheshim me ju me telefon

Rruga

No.

Block

Apartment

Rajoni

(Bregdetar-1 ; Qendror-2; Malor-3; Tirana-4)

Zona

(Urbane-1, Rurale-2)

Tel shtëpise

I pa disponueshem

Celulari

I pa disponueshem

4

Gjuha

Në cilën gjuhë do të preferonit të merrnit informacion të mëtejshëm në lidhje me kërkesën tuaj?

shqip

5

Grupi etnik

Shqiptar

☐

Grek

☐

Roma

☐

Maqedonas

☐

Malazezë

☐

Vllahe

☐

Te tjera

6

Certifikatë familjare

A	B	C	D	E	F	G	H	J
EMRAT E ANËTAREVE TË FAMILJES: BËNI NJË LISTË TË PLOTË TË TË GJITHË PERSONAVE NE FJALE PARA SE SHKONI TEK PYETJET 4-10	Numri i identifikimit të personit (IDNP)	Seksi:	Data e lindjes (ditë/muaj/viti)	Mosha	Marredheniet me kryefamiljarin:	Gjendja civile	A përfiton [EMRI] pagesë të aftësisë së kufizuar / pension invaliditeti?	Kryerja e vaksinimit sipas kalendarit të detyrueshëm për grup moshat e fëmijëve.
	Tregoni N / A, nëse asnjë	M 1 F 2			Kryefamiljari 1 Bashkeshortja/Partneri 2 Fëmija/fëmija i adoptuar 3 Niper 4 Mbesa 5 Baba/mama 6 Motër / vella 7 SON, Dhender/Nuse 8 Kumatë/kumata 9 Gjysh/gjyshe 10 Vjehër/vjehërre 11 Të afërm të tjerë 12 Jo të afërm 13	1. I martuar 2. Divorcuar/ndarë 3. Jetojnë së bashku 4. I ve/vejushë 5. Beqar		
1							po 1 jo 2	po 1 jo 2
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								

